



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI I FILOLOGJISË

Rr. Xhorxh Bush, nr. 31, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383-38-222970 • E-mail: filologjia@uni-pr.edu • www.filologjia.uni-pr.edu

Këshilli i Fakultetit të Filologjisë

Nr. Prot.: 01/ 2352

Data: 14/7/2026

Këshilli i Fakultetit të Filologjisë në mbledhjen e jashtëzakonshme të datës 14.7.2026, shqyrtoi raportet e komisioneve vlerësuese të emëruara për shqyrtimin e dosjeve të aplikantëve sipas Thirrjes publike me 1/746, dt. 29.5.2026 për angazhimin e profesorëve dhe asistentëve të angazhuar për ligjërata dhe ushtrime në bazë të nevojave të njësive akademike të UP – së për vitin akademik 2026/27 si dhe raportet përkatëse të komisionit të ankesave, për pozitat e pikës III të Fakultetit të Filologjisë, mori:

V E N D I M

1. Një profesor për mbajtjen e ligjëratave për lëndët: Hyrje në mësimdhënie dhe mësimnxënie (BA), Testimi dhe vlerësimi (BA), Hyrje në mësimdhënie dhe mësimnxënie (BA), Planifikimi i orës mësimore (BA), Mësimdhënia e anglishtes për grupmoshat e reja (BA). Nga komisioni vlerësues për pozitën III.1 propozohet për angazhim i kandidates : PhD Rina Krasniqi. Këshilli i Fakultetit të Filologjisë e miraton propozimin e komisionit vlerësues.
2. Një asistent për mbajtjen e ushtrimeve për lëndët : Zhanret e gazetarisë I, Media dhe politika, Sistemi politik i BE-së, Zhanret e gazetarisë II, Intervista&Talk Shou, Sistemi politik i BE-së. Nga komisioni vlerësues për pozitën III.3 propozohet për angazhim i kandidates : MA Arbenita Hoxhaj Rama. Këshilli i Fakultetit të Filologjisë e miraton propozimin e komisionit vlerësues.
3. Një asistent për mbajtjen e ushtrimeve për lëndët:: Gazetari e televizionit, Prezantim dhe moderim, Gazetari Sportive, E drejta e medias dhe politikat mediale, Hyrje në teorinë e komunikimit, Hulumtimi i Audiencës. Nga komisioni vlerësues për pozitën III.4 propozohet për angazhim i kandidates : MA Hyrije Mehmeti. Këshilli i Fakultetit të Filologjisë e miraton propozimin e komisionit vlerësues.
4. Një asistent për mbajtjen e ushtrimeve për lëndët : Redaktimi në media, Produksion dhe Postproduksion, Komunikimi strategjik, Komunikimi politik, Komunikimi në kohë krize.

Nga komisioni vlerësues për pozitën III.5 propozohet për angazhim i kandidatës : PhD Emira Bajçinca. Këshilli i Fakultetit të Filologjisë e miraton propozimin e komisionit vlerësues.

Arsyetim

Këshilli i Fakultetit të Filologjisë, në ushtrimin e kompetencave të tij sipas Rregullores nr. 2/254, datë 17.7.2024, shqyrtoi në tërësi raportet e Komisioneve Vlerësuese, raportet e Komisionit të Ankesave, dokumentacionin e kandidatëve dhe të gjitha aktet e administruara gjatë procedurës së konkursit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit Këshilli mori në konsideratë edhe raportet e Komisionit të Ankesave, i cili, pas shqyrtimit të pretendimeve të kandidatëve, konstatoi se Komisionet Vlerësuese kanë zbatuar drejt kriteret e konkursit dhe dispozitat e Rregullores nr. 2/254, ndërsa pretendimet e ngritura nuk provojnë ekzistimin e ndonjë shkeljeje të procedurës apo të kriterëve të vlerësimit. Pretendimet që lidhen me vlerësimin e publikimeve shkencore, përvojës akademike, konferencave dhe trajnimeve paraqesin mospajtim me rezultatin e vlerësimit profesional dhe nuk përmbajnë fakte apo prova që do të cenonin ligjshmërinë e raporteve të Komisioneve Vlerësuese.

Këshilli i Fakultetit konstatoi gjithashtu se kandidatët e propozuar i plotësojnë kërkesat akademike të pozitave përkatëse dhe se fushat e tyre të doktoratës dhe studimeve master janë në përputhje me fushën e lëndëve për të cilat janë shpallur pozitat në konkurs. Dhe në këtyre ata përmbushin kërkesat akademike dhe të mësimdhënies të njësisë akademike.

Në këto rrethana, Këshilli vlerëson se nuk ekziston asnjë bazë faktike dhe juridike për të mos miratuar propozimet e Komisioneve Vlerësuese. Çdo rivlerësim i meritave relative të kandidatëve do të nënkuptonte zëvendësimin e vlerësimit profesional të organit kompetent me një vlerësim të ri nga Këshilli, gjë që nuk parashihet nga Rregullorja nr. 2/254 dhe do të tejkalonte kompetencat e tij. Për rrjedhojë, duke qenë se procedura është zhvilluar në pajtim me dispozitat rregullative, kriteret e konkursit janë zbatuar në mënyrë të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe nuk është konstatuar asnjë shkelje që do të ndikonte në ligjshmërinë e procesit apo të rezultatit të tij, Këshilli i Fakultetit miraton propozimet e Komisioneve Vlerësuese.

DEKAN:

Prof.asoc. Abdulla Rexhepi

